



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P. 618/2018

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 20.09.2018 shqyrtoi ankesat përkatësisht me:

Objekt:

Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me skualifikimin e ofertës së bashkimit të operatorëve ekonomikë “Dajti Park 2007” sh.p.k. & “Nika” sh.p.k., në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me nr. REF-67644-05-08-2018, me objekt “Ndërtim rrjet ujësjellësi dhe kanalizime në zonën e Lanabregasit, Faza II”, me fond limit 64.369.208 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 22.06.2018, nga autoriteti kontraktor, Ujësjellës Kanalizime Tiranë sh.a.

Ankimues:

Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Dajti Park 2007” sh.p.k. & “Nika” sh.p.k.
Dajti, Lagja “Qesarake”, godinë banimi dhe shërbimesh 3, 4 kate + nëncati + 2 kate bodrum, kati I, Tiranë

Autoriteti Kontraktor:

Ujësjellës Kanalizime Tiranë sh.a.
Rruga “5 Maji”, pranë Medresesë, Tiranë

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.

914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorët e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

I.2. Bashkimi i operatorëve ekonomikë ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 09.05.2018, është publikuar nga autoriteti kontraktor, në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “Procedurë e hapur”, me nr. REF-67644-05-08-2018, me objekt “Ndërtim rrjet ujësjellësi dhe kanalizime në zonën e Lanabregasit, Faza II”, me fond limit 64.369.208 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 22.06.2018, nga autoriteti kontraktor, Ujësjellës Kanalizime Tiranë sh.a.

II.2. Në datën 22.06.2018, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3 Nga verifikimi në sitimin e prokurimit elektronik (SPE) si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor në datë 05.07.2018 ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesmarrës në këtë procedurë prokurimi të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. BOE “Dajti Park 2007” sh.p.k. & “Nika” sh.p.k. 48.684.511 lekë, skualifikuar
2. BOE “Sireta 2F” sh.p.k. & “Artyka II” sh.p.k. 54.601.953 lekë, skualifikuar
3. BOE “Colombo” sh.p.k. & “Aluera” sh.p.k. 55.014.003 lekë, skualifikuar
4. “Senka” sh.p.k. 56.194.845 lekë, skualifikuar
5. “Viante Konstruksion” sh.p.k. 57.020.101,95 lekë, skualifikuar
6. BOE “Kombeas” sh.p.k. & “Arjeil” sh.p.k. 59.505.757 lekë, kualifikuar
7. “Shans Invest” sh.p.k. 59.962.224 lekë, kualifikuar
8. “ANK” sh.p.k. 62.890.302 lekë, kualifikuar
9. “Liqeni VII” sh.p.k. 63.210.541 lekë, skualifikuar
10. “Biba X” sh.p.k. 64.368.021 lekë, skualifikuar

II.4. Në datën 05.07.2018, bashkimi i operatorëve ekonomikë “Dajti Park 2007” sh.p.k. & “Nika” sh.p.k. është njoftuar elektronikisht për vlerësimin e procedurës së prokurimit si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë për arsyet si më poshtë vijon:

“Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të nenit 53 të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe Kreut VII, neni 66, pika 3 të VKM Nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga ky operator ekonomik, nga ku rezultoi si më poshtë: 2.3 Kapaciteti teknik: Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale të cilat vendosen nga Autoriteti Kontraktor si më poshtë: 1. Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën: a. Punë të ngjashme për një objekt të vetëm me vlerë 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe konkretisht: 32.184.604 (tridhjetë e dy milion e njëqind e tetëdhjetë e katër mijë e gjashtëqind e katër) lekë pa TVSH, të realizuar gjatë tri viteve të fundit. b. Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë tre viteve të fundit është në një vlerë sa dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet dhe konkretisht: 128.783.416 (njëqind e njëzet e tetë milion e shtatëqind e tetëdhjetë e tre mijë e katërqind e gjashtëmbëdhjet) lekë pa TVSH. Plotesimi i njerit prej dy kushteve të sipërpermendura e bën ofertën të kualifikueshme. Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme: a) Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm: 1. Deklaratën sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me: 2. Kontratë 3. Situacionin përfundimtar; 4. Aktin e kolaudimit; 5. Çertifikatën e marrjes në dorezim. b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm: 1. Deklaratën sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me: 2. Kontrate; 3. Situacionin përfundimtar; 4. Akt kolaudimi objekti; 5. Çertifikatën e marrjes në dorezim të objektit; 6. Fatura tatimore për çdo situacion punimesh. Pika 1/a plotësohet nga anëtarë të cilët ka përfaqësuar më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin

kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Shoqëria "DAJTI PARK 2007" SH.P.K ka paraqitur elektronikisht për të përmbushur kriterin e mësipërm kontratat si më poshtë: 1- Kontrata me nr. Prot 270/9 e datës 12.09.2017 me objekt "Rikonstruksion i pesë godinave ekzistuese dhe ndërtimi i sistemit të ngrohjes në QKP. Azilkërkuesit në Babrru" me vlerë të saj 61.986.805.8 lekë pa TVSH. 2- Kontrata me nr. Prot., 2250 datë 07.09.2016 " Ndërtim K.U.Z Fshati Strum" me vlerë kontrate 14.503.314 lekë pa TVSH, e cila është realizuar nga B.O.E "Glavenica sh.p.k & "DAJTI PARK 2007" SH.P.K ku shoqëria "DAJTI PARK 2007" SH.P.K ka realizuar 55% të punimeve në vlerën 7.976.822,7 lekë pa TVSH. 3- Kontrata me nr.prot 2395 e datës 20.06.2016 "Sistemim-asfaltim rruga e rezervave Halil" me vlerë të kontratës 10.304.531 lekë pa TVSH. 4 - Kontrata me nr. Prot., 6020 datë 29.06.2016 " Ndërtim I ri i kopshtit "7 Marsi" me vlerë kontrate 25.130.542.5 lekë pa TVSH, e cila është realizuar nga B.O.E "Compani Riviera 2008" sh.p.k & "DAJTI PARK 2007" SH.P.K ku shoqëria "DAJTI PARK 2007" SH.P.K ka realizuar 53.2% të punimeve në vlerën 13.369.448,6 lekë pa TVSH. 5- Kontrata me nr.ref.40 e datës 31.08.2015 "Rikonstruksion I shkollës 9-vjecare Fshati Sheq Musalala, Komuna Frakull" me vlerë kontrate 16.010.614 lekë pa TVSH e cila është realizuar nga B.O.E "Glavenica sh.p.k & "DAJTI PARK 2007" SH.P.K ku shoqëria "DAJTI PARK 2007" SH.P.K ka realizuar 63.5% të punimeve në vlerën 10.166.739,9 lekë pa TVSH. 6- Kontrata me nr.prot 7123/7 e datës 20.10.2016 "Ndërtim I rrjetit TM 20KV për furnizimin e kabinës e re Tip Box (Xhamia popullore) në fiderin A.12, Nënstacioni Rajonal dhe rrjetit TU ABC" me vlerë të kontratës 10.998.753 lekë pa TVSH. 7- Kontrata me nr.prot 6059/1 e datës 23.12.2015 "Rrethim I jashtëm I garnizionit Qëndër dhe depove të armatimitmonucionit Zall-Her" me vlerë të kontratës 20.162.209 lekë pa TVSH. 8- Kontrata me nr.prot 671 e datës 13.01.2017 "Mbyllje kanali "Kashta e Kumrit" Lgj 15. me vlerë të kontratës 5.691.700 lekë pa TVSH. Pra sa më sipër cituar shoqëria "DAJTI PARK 2007" SH.P.K në kontratat e paraqitura për plotësimin e kriterit mbi përvojën e mëparëshme si punë të ngjashme nuk ka paraqitur asnjë kontratë me objekt Ndërtim ose Rikonstruksion Rrjet ujësjellësi dhe si rrjedhojë përkatësisht duke ju referuar Preventivit të këtij objekt prokurimi "DAJTI PARK 2007" SH.P.K si përfaqësues i B.O.E "DAJTI PARK 2007" SH.P.K & NIKA" SH.P.K nuk ka paraqitur kontratë të ngjashme me zërat në preventive. Duke qënë se në kontratën e bashpunimit të OE me Nr. 2487 rep., Nr. 895 kol. Datë 19.06.2018 palët marrin përsipër ndarjen e punimeve: 60% të punimeve do të kryhen nga operatori "DAJTI PARK 2007" SH.P.K dhe 40% të punimeve do të kryhen nga operatori "NIKA" SH.P.K, nga ku rezulton se OE "DAJTI PARK 2007" SH.P.K ka marrë përsipër të realizoj zëra të punimeve, të cilat nuk rezultojn të jenë me natyrë të ngjashme në asnjë nga kontratat sipërcituara të paraqitura prej tij. Si rrjedhojë ky OE nuk zotëron kapacitet të mjaftueshëm teknik për sa i përket përvojës së suksesshme në realizimin e kontratave pune të ngjashme për të realizuar kontratën për këtë objekt prokurimi duke mos përmbushur Kriteret e veçanta për kualifikim, Kapaciteti Teknik dhe profesional, pika 1/a dhe pika 1/b, cka bie në kundërshtim me pikën 1 germa (b) të nenit 46 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin Publik" i ndryshuar ku përcaktohet se: Operatorët ekonomik, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtëme që AK i vlerëson të nevojshme..... Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 53 pika 5, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për Prokurimin publik" (i ndryshuar) dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të

prokurimit publik”, Kreu VII, Neni 66 pika 3, e shpall të pavlefshme këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

II.5. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Dajti Park 2007” sh.p.k. & “Nika” sh.p.k. në datën 11.07.2018 ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar skualifikimin e ofertës së tij ekonomike në procedurën e prokurimit, sipas pretendimeve si më poshtë vijon:

[...] Në lidhje me pretendimin e ngritur nga ana juaj si autoritet kontraktor se shoqëria “Dajti Park 2007” shpk ne kontratat e paraqitura asnjë kontrate nuk është Ndertim apo Rikonstruksion Rrjet Ujesjellesi si dhe kontratat e paraqitura nuk janë ne natyren zerave te preventivit. Ju bejme me dije se ne kontratat e paraqitura nga ana jone pavarisist se ne emertim nuk jane “Ndertim ose Rikonstruksion Rrjet Ujesjellesi”, ne keto kontrata shumica e zerave jane te ngjashem me natyren e preventivit te ofertes, si: Shtrese Stabilizanti, Shtrese Binderi, Shtrese Asfaltobetoni, Germim dheu per kanale, Nenshtresë zhavorri, Shtrese Rere, Mbushje dheu, Transport Material i Germuar, Shtrese Betoni, Tub ujesjellesi PE Ø63mm, Tub ujesjellesi PE Ø50mm, Tub ujesjellesi PE Ø40mm, Tubacione furnizimi me uje te ndryshme, Saracineska te ndryshme, Hidrante Ø50, Tubacione kanalizimi të dimensioneve te ndryshme, Puseta kontrolli te dimensioneve te ndryshme, Tuba betoni per tombino, Kabell elektrik, Xhunto per kabllot, Hekur betoni, etj. Sic shikohet ne kontratat e paraqitura nga ana jone shumica e zërave jane te ngjashëm duke zene me pjesen me te madhe të zerave të preventivit te ofertës, cka tregon se kontratat e paraqitura nga ana jonë janë në natyrë të ngjashme me preventivin e ofertës. Gjithashtu duke marre shkas edhe nga Komisioni i Prokurimit Publik se per arsye të ngjashme skualifikimi, ky Komision ka marre ne konsiderate ankesat e paraqitura nga operatori te ndryshem ekonomike duke i kualifikuar ata. Gjithashtu ju bejme me dije se po i shkaktoni shtetit nje dem ekonomik prej 10.821.246 leke pa TVSH sic shikohet edhe nge renditje e operatorëve ekonomike. Në lidhje me sa më sipër kërkojmë nga ana juaj si autoritet kontraktor kualifikimin për këtë procedurë dhe të rishikoni edhe njëherë vlerësimin e kësaj procedure.

II.6. Në datën 11.07.2018, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues, nëpërmjet shkresës me nr. K-3062 prot., duke e refuzuar ankesën.

Konkretisht autoriteti kontraktor në kthimin e përgjigjes argumenton si më poshtë vijon:

[...] KSHA konstaton se elementët e kërkuar në preventivin e përcaktuar në dokumentat e tenderit nuk gjejnë pasqyrim në preventivat përkatës të kontratave të dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues “Dajti Park 2007” Sh.p.k për vërtetimin e eksperiencës së mëparshme. Sa më sipër, KSHA gjykon se operatori ekonomik ankimues nuk ka vërtetuar se gëzon eksperiencë të mëparshme në përputhje me objektin e procedurës së prokurimit. Në rastin konkret, KSHA vlerëson se kontratat e paraqitura nga operatori ekonomik ankimues në procedurën e prokurimit, nuk plotësojnë kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit dhe nuk mund të konsiderohet e vlefshme. [...]

II.7. Në datën 19.07.2018 bashkimi i operatorëve ekonomikë “Dajti Park 2007” sh.p.k. & “Nika” sh.p.k. ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik duke ngritur të njëjtat pretendime si në ankesën e ngritur pranë autoritetit kontraktor.

II.8. Nëpërmjet shkresës nr. K-3215/1 prot., datë 25.07.2018, protokolluar me tonën në datën 26.07.2018, me objekt “*Informacion i hollësishëm mbi zhvillimin e procedurës së prokurimit me objekt “Ndërtim rrjeti ujësjellësi dhe kanalizime në zonën e Lanabregasit, Faza II”*” është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit dhe trajtimin e ankesës së bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, si edhe informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues se [...] *ne kontratat e paraqitura nga ana jone pavarësisht se ne emertim nuk jane “Ndërtim ose Rikonstruksion Rrjet Ujesjellesi”, ne keto kontrata shumica e zerave jane te ngjashem me natyren e preventivit te ofertës, si: Shtrese Stabilizanti, Shtrese Binderi, Shtrese Asfaltobetoni, Germim dheu per kanale, Nenshtresë zhavorri, Shtrese Rere, Mbushje dheu, Transport Material i Germuar, Shtrese Betoni, Tub ujesjellesi PE Ø63mm, Tub ujesjellesi PE Ø50mm, Tub ujesjellesi PE Ø40mm, Tubacione furnizimi me uje te ndryshme, Saracineska te ndryshme, Hidrante Ø50, Tubacione kanalizimi të dimensioneve te ndryshme, Puseta kontrolli te dimensioneve te ndryshme, Tuba betoni per tombino, Kabell elektrik, Xhunto per kabllot, Hekur betoni, etj. Sic shikohet ne kontratat e paraqitura nga ana jone shumica e zerave jane te ngjashem duke zene me pjesen me te madhe të zerave të preventivit te ofertës, cka tregon se kontratat e paraqitura nga ana jonë janë në natyrë të ngjashme me preventivin e ofertës,* Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:

III.1.1. Në dokumentat e tenderit Shtojca 12 Kriteret e përgjithshme të pranimit /kualifikimit, pika 2.3. Kapaciteti teknik, pika 2.3.1., nga autoriteti kontraktor është përcaktuar kriteri: *Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale të cilat vendosen nga Autoriteti Kontraktor si më poshtë:*

1. *Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:*

- a. *Punë të ngjashme për një objekt të vetëm me vlerë 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe konkretisht: 32.184.604 (tridhjetë e dy milion e njëqind e tetëdhjetë e katër mijë e gjashtëqind e katër) lekë pa TVSH, të realizuar gjatë tri viteve të fundit.*
- b. *Punë të ngjashme deri ne nje kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë tre viteve të fundit është në një vlerë sa dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet dhe konkretisht: 128.783.416 (njëqind e njëzet e tetë milion e shtatëqind e tetëdhjetë e tre mijë e katërqind e gjashtëmbëdhjet) lekë pa TVSH.*

Plotesimi i njerit prej dy kushteve te siperpermendura e bën oferten te kualifikueshme.

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

- a) *Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:*
 1. *Deklaratën sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me:*
 2. *Kontratë*
 3. *Situacionin përfundimtar;*
 4. *Aktin e kolaudimit;*
 5. *Çertifikaten e marrjes ne dorezim.*
- b) *Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:*
 1. *Deklaratën sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me:*
 2. *Kontrate;*
 3. *Situacionin përfundimtar;*
 4. *Akt kolaudimi objekti;*
 5. *Çertifikaten e marrjes ne dorezim te objektit;*
 6. *Fatura tatimore per cdo situacion punimesh.*

Pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

III.1.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të bashkimit të operatorëve ekonomikë “Dajti Park 2007” sh.p.k. & “Nika” sh.p.k. rezulton se, është paraqitur dokumenti Kontratë Bashkëpunimi, ndërmjet shoqërisë “Dajti Park 2007” sh.p.k., shoqërisë “Nika” sh.p.k., nga ku shoqëria “Dajti Park 2007” sh.p.k. merr përsipër të kryejë 60% të vlerës së përgjithshme të punimeve, dhe shoqëria “Nika” merr përsipër të kryejë 40% të vlerës së përgjithshme të punimeve.

Gjithashtu është paraqitur edhe dokumenti Prokurë e Posaçme, sipas së cilës shoqëria “Dajti Park 2007” sh.p.k. është përfaqësuese e këtij bashkimi operatorësh ekonomikë.

III.6.3. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të bashkimit të operatorëve ekonomikë, konstatohet se është paraqitur dokumentacioni i mëposhtëm në përmbushje të kriterit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor:

Shoqëria “Dajti Park 2007” sh.p.k. ka paraqitur kontratat e mëposhtme:

- Kontratë me objekt “Rrethimi i jashtëm i garnizonit qendër dhe depove të armatim municionit Zall-Herr” me Nr. Prot., 6059/1 të datës 23.12.2015, me vlerë 20.171.672 lekë pa tvsh, ku përqindja e punimeve të marra përsipër nga shoqëria “Dajti Park 2007” sh.p.k. është në masën 100%, shoqëruar me situacion përfundimtar, akti i kolaudimit, formular vlerësimi;
- Kontratë “Ndërtim i rrjetit TM 20 KV” me Nr. Prot., 7123/7, datë 20.10.2016 me vlerë 10.998.753 lekë pa tvsh, ku përqindja e punimeve të marra përsipër nga shoqëria “Dajti Park 2007” sh.p.k. është në masën 100%, shoqëruar me situacion përfundimtar, akt kolaudimi, formular vlerësimi;
- Kontratë “Rikonstruksion i pesë godinave ekzistuese dhe ndërtimi i sistemit të ngrohjes në QKP Azillkërkuesve, Babrru”, me Nr. Prot., 270/9, datë 12.09.2017 me vlerë 61.990.310

lekë pa tvsh, , ku përqindja e realizimit të punimeve të marra përsipër nga shoqëria “Dajti Park 2007” sh.p.k. është në masën 100%; shoqëruar me situacioni përfundimtar; akti i kolaudimit, formular vlerësimi;

- Kontratë ”Rikonstruksion i shkollës 9 vjecare, fshati Sheq Musalalaj, Komuna Frakull” e datës 31.08.2015, me vlerë 16.010.614 lekë pa tvsh me afat realizimi 6 muaj, ku përqindja e realizimit të punimeve të marra përsipër nga kompania ”Dajti Park 2007” sh.p.k. është në masën 63.5%, shoqëruar me situacion përfundimtar, akt kolaudimi, formular vlerësimi;
- Kontratë ”Ndërtim i ri Kopështi 7 Marsi” me Nr. Prot., 6020, datë 29.06.2018, me vlerë 25.130.543 lekë pa tvsh me afat realizimi 120 ditë, ku përqindja e realizimit të punimeve të marra përsipër nga kompania ”Dajti Park 2007” sh.p.k. është në masën 53.2%, shoqëruar me situacion përfundimtar, akt kolaudimi, formular vlerësimi;
- Kontratë ”Ndërtim KUZ fshati Strumë, Bashkia Rroskovec” me Nr. Prot., 2250, datë 07.09.2016, me vlerë 14.503.314 lekë pa tvsh me afat realizimi 90 ditë, ku përqindja e realizimit të punimeve të marra përsipër nga kompania ”Dajti Park 2007” sh.p.k. është në masën 55%, shoqëruar me situacion përfundimtar, akt kolaudimi, formular vlerësimi;
- Kontratë ”Mbyllje kanali Kashta e Kuntrit, lagja 15 Durrës” me Nr. Prot., 671, datë 13.01.2017, me vlerë 5.691.700 lekë pa tvsh me afat realizimi 90 ditë, ku përqindja e realizimit të punimeve të marra përsipër nga kompania ”Dajti Park 2007” sh.p.k. është në masën 100%, shoqëruar me situacion përfundimtar, akt kolaudimi, formular vlerësimi;
- Kontratë ”Sistemim asfaltim rruga e rezervave Halil” me Nr. Prot., 2395, datë 20.06.2016, me vlerë 10.304.531 lekë pa tvsh me afat realizimi 11 muaj, ku përqindja e realizimit të punimeve të marra përsipër nga kompania ”Dajti Park 2007” sh.p.k. është në masën 100%, shoqëruar me situacion përfundimtar, akt kolaudimi, formular vlerësimi;

Shoqëria “Nika” sh.p.k. ka paraqitur kontratat e mëposhtme:

- Kontratë me objekt ”Skema ujitëse e Fushës së Milotit, Mamurrasit, Drojes, Kanalet Sekondare Ujitëse U-111, U-112, U-113, U-114 dhe U-115 të Kanalit Ujitës U-11” me Nr. Prot., 642/11, datë 28.06.2016, me vlerë 11.551.274 lekë pa tvsh me afat realizimi 2 muaj, ku përqindja e realizimit të punimeve të marra përsipër nga kompania ”Nika” sh.p.k. është në masën 100%, shoqëruar me situacion përfundimtar, akt kolaudimi, formular vlerësimi;
- Shtesë kontrate sipërmarrje me objekt ” Skema ujitëse e Fushës së Milotit, Mamurrasit, Drojes, Kanalet Sekondare Ujitëse U-111, U-112, U-113, U-114 dhe U-115”, Nr.9623/14, datë 27.02.2017, me vlerë 2.298.704 lekë (pa TVSH), me autoritet kontraktor Bashkia Kurbin.

III.1.3. Në Kreun VIII, neni 74, “Bashkimi i operatorëve ekonomikë”, pika 1 e VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet: *“Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe në rast përzgjedhjeje edhe gjatë zbatimit të kontratës.*

Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi”. Në Kreun VIII, neni 74, pika 2 po këtu, parashikohet: “Para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Pas krijimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë, anëtarët e bashkimit caktojnë me prokurë përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo marrëveshje e shkruar dhe prokura duhet të dërgohen së bashku me

kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi...”, ndërsa në pikën 3 parashikohet: “Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje”.

III.1.4. Në nenin 46, pika 1, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.”*

III.1.5. Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcakohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.”*

III.1.6. Neni 26, pika 6 e VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave për prokurimin publik”, i ndryshuar parashikon: *“Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon:*

- a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit.*
- b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë tri viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.*

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Autoriteti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik ku të shënohen vlera, koha dhe natyra e punës së bërë dhe çdolloj dokumenti tjetër, që parashikohet në legjislacionin në fuqi, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshmetë punëve.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti kontraktor kërkon si dëshmi vërtetime ku të shënohen vlera, koha dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdolloj dokumenti tjetër, që parashikohet në legjislacionin në fuqi, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve”.

III.1.7. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.1.8. Sqarojmë se, referuar rregullave të prokurimit publik, përmbushja e kriterëve dhe kërkesave të autoritetit kontraktor duhet të bëhet nga secili anëtar i bashkimit në përputhje me përqindjen e punëve të marra përsipër. Sa më sipër, referuar kushteve të vendosura nga autoriteti kontraktor për sa i përket kontratave të ngjashme, si dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Dajti Park 2007” sh.p.k. & “Nika” sh.p.k., konstatojmë se operatori ekonomik me përqindjen më të madhe në këtë bashkim (“Dajti Park 2007” sh.p.k. me 60%), nuk ka paraqitur një kontratë të ngjashme për një objekt të vetëm në vlerën

50% e vlerës së përlogaritur të kontratës që do të prokurohet, sic është kërkuar në dokumentat e tenderit. Përsa i përket kushtit të dytë, nga shqyrtimi i të gjitha kontratave të paraqitura nga secili prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ekonomikë “Dajti Park 2007” sh.p.k. & “Nika” sh.p.k., në përmbushje të kriterit për kontratat e ngjashme, KPP konstaton se, operatori ekonomik “Nika” sh.p.k. si pjesëtar i bashkimit të përkohshëm të shoqërive, në dokumentacionin e paraqitur për plotësimin e kriterit për sa i përket kontratave të ngjashme, nga përlogaritja nuk plotëson kushtin e vendosur nga autoriteti kontraktor për sa i përket vlerës që duhet të plotësojnë këto kontrata në përputhje me përqindjen që operatori ekonomik ka marrë përsipër të realizojë në kontratën e bashkëpunimit. Pra, ky bashkim operatorësh ekonomikë nuk ka paraqitur kontrata të ngjashme sipas kërkesave të autoritetit kontraktor të përcaktuara në dokumentat e tenderit, duke mos provuar në këtë mënyrë plotësimin e kriterit të kontratave të ngjashme në përputhje me përqindjen e marrë përsipër në kontratën e bashkëpunimit.

III.1.9. Sa më sipër, KPP gjykon se, kriteret për kualifikim i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në këtë kuptim, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron eksperiencat e mëparshme të ngjashme me objektin e prokurimit por, edhe në përputhje me volumin e përcaktuar në dokumentat e tenderit. Në këto kushte, KPP gjykon se bashkimi i operatorëve ekonomikë “Dajti Park 2007” sh.p.k. & “Nika” sh.p.k. nuk e ka përmbushur kriterin e vendosur nga autoriteti kontraktor për sa i përket kontratave të ngjashme.

Rrjedhimisht sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 28 të VKM-së nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Dajti Park 2007” sh.p.k., për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur”, me nr. me nr. REF-67644-05-08-2018, me objekt “Ndërtim rrjet ujësjellësi dhe kanalizime në zonën e Lanabregasit, Faza II”, me fond limit 64.369.208 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 22.06.2018, nga autoriteti kontraktor, Ujësjellës Kanalizime Tiranë sh.a.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.

4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1280 Protokolli

Datë 19.07.2018

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha

